



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

*Agencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency*



# METODOLOGJIA E AKA-SË

për Monitorim dhe  
Procedura pas Akredituese



# **Metodologjia e AKA-së**

për monitorim dhe procedura pas akredituese

Në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë të Republikës së Kosovës Nr. 04/L-037, Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë 15/18, si dhe Manualin e Akreditimit të AKA-së, AKA do të organizojë procedurat pas akredituese si dhe procedurat e monitorimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit.

Dokumenti në vijim do të shërbejë si udhërrëfyes për AKA-në, institucionet e arsimit të lartë, ekspertët ndërkombëtarë si dhe publikun e gjerë për zbatimin e procedurave të drejta dhe transparente pas akredituese dhe të monitorimit.

Dokumenti në vijim përmbush Standardin 2.3 të Udhëzuesve Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG) i cili kërkon që agjencitë e sigurimit të cilësisë të përmbyllin ciklin e akreditimit me procedura pas akredituese të cilat kanë për qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë.

Standardi 2.3. përcakton se forma e procedurave pas akredituese varet nga modeli i sigurimit të jashtëm të cilësisë, andaj AKA përmes këtij dokumenti prezanton procedurat e monitorimit të cilat i përshtaten plotësisht kontekstit dhe sistemit kosovar të sigurimit të cilësisë si dhe janë në përputhje me legjisllacionin vendor në fuqi.

Për qëllime të procedurave të monitorimit dhe pas akreditimit do të trajtohen si të njëjta proceset e akreditimit, riakreditimit dhe validimit të IAL-ve, përveç nëse është e përcaktuar ndryshe.

**Dizajni:**  
Envinion

# PËRMBAJTJA

PËRKUFIZIMET .....	06
1. PROCEDURAT E MONITORIMIT .....	09
1.1. Organizimi i procedurës së monitorimit nga AKA .....	10
1.2. MONITORIM I PËRGJITHSHËM .....	11
1.3. Monitorimi i bartësve të programit të studimit .....	11
1.4. Monitorimi i ueb faqeve zyrtare dhe materialeve reklamuese të IAL-ve.....	12
1.5. MONITORIMIN SIPAS STANDARDEVE TË MANUALIT TË AKREDITIMIT .....	14
1.6. Monitorimi i stafit akademik.....	14
1.7. Monitorimi i orareve të ligjëratave dhe ushtrimeve.....	16
1.8. Monitorimi i infrastrukturës dhe resurseve .....	18
1.9. MONITORIM I JASHTËZAKONSHËM .....	20
Monitorimi i iniciuar pas pranimit të ankesave nga palët e jashtme .....	20
1.10. Dorëzimi i dëshmimeve të rrejshme në AKA .....	21
1.11. Monitorimi në bashkëpunim me Inspektoratin e Arsimit .....	22
2. PROCEDURAT PAS AKREDITUESE .....	25
2.1. Organizimi i procedurës pas akredituese nga AKA .....	26
2.2. Dorëzimi i raportit fillestar të përmirësimit.....	27
2.3. Dorëzimi i raportit përfundimtar të përmirësimit .....	27
2.4. Angazhimi i ekspertit ndërkombëtar të akreditimit .....	28
2.5. Organizimi i vizitës fizike pas akredituese në institucionin e arsimit të lartë.....	29
2.6. Konfirmimi i raportit të procedurës pas akredituese nga KSHC .....	31

# PËRKUFIZIMET

**“Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA)”** - është agjenci për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, e cila është përgjegjëse për vlerësimin, akreditimin, riakreditimin, validimin, kontrollin e cilësisë dhe monitorimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit;

---

**“Akreditim i programit të studimit”** - proces formal i vlerësimit të cilësisë, i cili përcakton statusin zyrtar të njohjes të dhënë nga AKA, i cili i mundëson institucionit të arsimit të lartë dhënien e kualifikimeve për fushën përkatëse brenda një periudhe të caktuar kohore;

---

**“Akreditim institucional”** - proces formal i vlerësimit të cilësisë, i cili përcakton statusin zyrtar të njohjes të dhënë nga AKA për institucionin e arsimit të lartë, i cili i mundëson zhvillimin e aktivitetit akademik dhe të drejtën e dhënies së kualifikimeve për një periudhë të caktuar kohore;

---

**“Akreditim”** - proces formal i vlerësimit të cilësisë së një institucioni të arsimit të lartë dhe/ apo i programeve të tij të studimit, përmes të cilit Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) përcakton se janë plotësuar standardet dhe kriteret e kërkuara të cilësisë;

---

**“Institucion i arsimit të lartë” (IAL)** - çdo institucion i autorizuar për ofrimin e shërbimeve arsimore në arsimin e lartë, të cilat janë subjekt i vlerësimit dhe monitorimit nga AKA;

---

**“Institucion privat i arsimit të lartë”** - çdo institucion i themeluar nga një kompani private, fondacion apo trust, siç përcaktohet me Ligjin për Arsimin e Lartë;

---

**“Institucion publik i arsimit të lartë”** - institucion i cili mund të krijohet me vendim të ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë, siç përcaktohet në Ligjin për Arsimin e Lartë;

---

**“Këshilli Shtetëror i Cilësisë”- (KSHC)** - organi më i lartë politikbërës dhe vendimmarrës i AKA-së;

**“Kontrolli dhe avancimi i cilësisë”** - proces i rregullt periodik i kryer me anë të proceseve të vlerësimit, kontrollimit dhe monitorimit nga AKA, përmes së cilit sigurohet se kriteret minimale të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të tyre të studimit mirëmbahen në vazhdimësi;

---

**“Ministria”**- Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI);

---

**“Monitorim”** - proces formal i kryer nga AKA përmes së cilit vlerësohet se institucioni i arsimit të lartë mirëmban dhe vazhdon të plotësojë, rekomandimet e vlerësuesve të jashtëm dhe kushtet e dhëna të akreditimit si dhe zbaton standardet e Manualit të Akreditimit.

---

**“Procedura pas akredituese”** - proces i cili kufizohen në verifikimin e kushteve të akreditimit dhe konfirmimin e shkallës së përmbushjes së rekomandimeve nga AKA dhe zotimeve nga IAL dhe jo në rivlerësimin e standardeve të Manualit të Akreditimit.

---

**“Program i studimit”** - program i cili shpie në një kualifikim ose diplomë, që jepet nga një bartës i arsimit të lartë ashtu siç përcaktohet në vendimin për akreditim;

---

**“Sigurimi i cilësisë”** - nënkupton tërësinë e politikave, proceseve dhe aktiviteteve në nivel shtetëror dhe institucional për sigurimin dhe avancimin e cilësisë në arsimin e lartë. Sigurimi i cilësisë, po ashtu ka të bëjë me mësimdhënien dhe të nxënit në arsimin e lartë, përfshirë edhe mjedisin e të nxënit dhe ndërlidhjet me kërkimin shkencor dhe inovacionin;

---

**“Standardet”** - kërkesa, kritere dhe rregulla të cilat përkufizojnë nivelin e kërkuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe programet e studimit për marrjen e vendimit pozitiv për akreditim;

---

**“Validim”** - procedurë e njohjes së akreditimit të dhënë nga një institucion i pranuar ndërkombëtar i akreditimit;

---

**“Vlerësimi i brendshëm”** - procesi i rregullt i vlerësimit të brendshëm nga institucioni i arsimit të lartë, përmes së cilit mirëmbahet cilësia dhe pajtueshmëria me standardet dhe kriteret e vendosura të sigurimit të cilësisë;

---

**“Vlerësimi i jashtëm”** - proces formal i vlerësimit të cilësisë, i kryer nga AKA, i cili rezulton në dhënien e një rekomandimi për akreditim, mosakreditim;





# 1

## PROCEDURAT E MONITORIMIT

AKA zhvillon procedura të monitorimit të cilat kanë për qëllim të verifikojnë dhe konfirmojnë nëse kushtet e dhëna të akreditimit si dhe standardet e Manualit të Akreditimit vazhdojnë të zbatohen nga institucionet e akredituara të arsimit të lartë. Këto procedura zbatohen në nivel institucional dhe/ apo në nivel të programeve të studimit dhe nuk dyfishohen me procedurën pas akredituese e cila fokusohet vetëm në përmbushjen e rekomandimeve të dhëna në raportet e vlerësimit të jashtëm. Procedurat e monitorimit ndahen në:



Monitorimin e përgjithshëm;



Monitorimin sipas standardeve të Manualit të Akreditimit;



Monitorimin e jashtëzakonshëm.

## **1.1. Organizimi i procedurës së monitorimit nga AKA**

- 1.1.1. AKA organizon procedurën e monitorimit të paktën njëherë brenda 6 (gjashtë) muajve në nivelin institucional dhe/apo të programit të studimit për çdo institucion të akredituar të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.
- 1.1.2. Procedurat e monitorimit përfshijnë verifikimin e përmbushjes së kushteve teknike të akreditimit nga institucioni i arsimit të lartë në nivelin institucional dhe të programit të studimit.
- 1.1.3. Procedurat e monitorimit mund të zhvillohen në distancë përmes shkëmbimit të dokumentacionit në mënyrë elektronike dhe/apo përmes vizitave fizike në hapësirat e institucionit të arsimit të lartë.
- 1.1.4. Monitorimi, në cilëndo prej formave të tij, kryhet nga zyrtarë të AKA-së.
- 1.1.5. Institucioni i arsimit të lartë njoftohet zyrtarisht nga AKA për fillimin e procedurës së monitorimit. Vizitat fizike të monitorimit mund realizohen me apo pa paralajmërim.
- 1.1.6. Në rast të organizimit të vizitës së monitorimit pa paralajmërim, zyrtarët e AKA-së me rastin e arritjes në institucionin e arsimit të lartë, do t'i bëjnë të ditur përfaqësuesit të institucionit që ka filluar procedura e monitorimit dhe për qëllimin e vizitës së monitorimit.
- 1.1.7. Zyrtarët e AKA-së ka të drejtë të mbledhin informata dhe dëshmi për të përmbushur qëllimin e vizitës.
- 1.1.8. Pas përfundimit të vizitës së monitorimit, Zyrtarët e AKA-së hartojnë një raport për mirëmbajtjen e kushteve teknike të akreditimit nga institucioni i arsimit të lartë i cili do të rishikohet dhe do të aprovohet në mbledhjen e KSHC-së.
- 1.1.9. Raporti i procedurës së monitorimit së bashku me vendimin e KSHC-së për institucionin përkatës të arsimit të lartë publikohet në ueb faqen zyrtare të AKA-së.
- 1.1.10. Raporti i procedurës së monitorimit është pjesë përbërëse e dokumentacionit për procedurën e ardhshme të ri/akreditimit të institucionit të arsimit të lartë.

## 1.2. MONITORIM I PËRGJITHSHËM

**Monitorimi i përgjithshëm përfshinë aktivitete të iniciuara nga AKA të cilat lidhen me zbatimin e vazhdueshëm të kushteve të dhëna të akreditimit në vendimin e KSHC-së dhe/apo kriteret e tjera formale të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. Monitorimi i përgjithshëm përfshinë, por nuk do të kufizohet vetëm në:**

### 1.3. Monitorimi i bartësve të programit të studimit

- 1.3.1. Të paktën një herë brenda 6 (gjashtë) muajve, AKA bënë monitorimin e bartësve të programit të studimit për çdo program të akredituar në Republikën e Kosovës.
- 1.3.2. Monitorimi i bartësve të programit të studimit mund të bëhet në distancë, përmes verifikimit të orarit të ligjëratave i cili kërkohet të bëhet publik në ueb faqen e institucionit dhe/apo përmes vizitës fizike të AKA-së me apo pa paralajmërim në hapësirat e institucionit të arsimit të lartë.
- 1.3.3. Institucioni i arsimit të lartë obligohet të njoftoj zyrtarisht AKA-në për largimin e ndonjërit prej bartësve të aprovuar nga KSHC, më së largu 14 ditë pas datës së largimit të bartësit.
- 1.3.4. Institucioni i arsimit të lartë obligohet të propozojë zëvendësimin e bartësit të programit të studimit me një bartës tjetër, më së largu 90 ditë pas datës së largimit të bartësit paraprak, i cili formalisht plotëson kriteret e përcaktuara
- 1.3.5. AKA bënë verifikimin e dokumentacionit të bartësit të zëvendësuar të programit të studimit për të vërtetuar përputhshmërinë me krit-

eret formale në fuqi.

- 1.3.6. AKA njofton formalisht KSHC-në për largimin dhe zëvendësimin e bartësit të programit të studimit në IAL dhe KSHC vendosë për aprovimin/refuzimin e bartësi të ri.
- 1.3.7. Në rast se institucioni dështon ta propozojë zëvendësimin e bartësit brenda periudhës kohore prej 90 ditëve, AKA njofton KSHC-në.
- 1.3.8. KSHC, pas pranimit të njoftimit zyrtar nga AKA, për mungesën e bartësit të programit të studimit, mund të procedojë me tërheqje të akreditimit për programin përkatës të studimit.
- 1.3.9. Pas marrjes së vendimit të KSHC-së, institucioni i arsimit të lartë mund të parashtojë ankesë sipas legjislacionit të AKA-së dhe ligjeve të përgjithshme në fuqi.

## **1.4. Monitorimi i ueb faqeve zyrtare dhe materialeve reklamuese të IAL-ve**

- 1.4.1. Të paktën një herë brenda 6 (gjashtë) muajve, AKA bënë monitorimin e ueb faqeve zyrtare të çdo institucioni të akredituar të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.
- 1.4.2. Monitorimi i ueb faqeve të IAL-ve bëhet me qëllim të sigurimit se informacionet e publikuara nga IAL-të në lidhje me akreditimin e programeve të studimit janë të sakta dhe nuk krijojnë konfuzion në mesin e studentëve, prindërve apo shoqërisë në përgjithësi. AKA gjithashtu verifikon nëse institucioni vazhdon t'i mbajë publike dokumentet dhe të dhënat e publikuara, ashtu siç kërkohet me Manualin e Akreditimit (përkatësisht të dhënat e programeve të studimit, CV-të e stafit akademik, dokumentet etj.).
- 1.4.3. Monitorimi i ueb faqeve të IAL-ve bëhet vetëm në distancë nga stafi i AKA-së dhe kufizohet vetëm në informatat të cilat prekin fushëveprimin ligjor të AKA-së.
- 1.4.4. Në rast se stafi i AKA-së vërteton përmes dëshmimeve të arsyeshme se institucioni i arsimit të lartë ka publikuar informata të cilat, në kuadër të fushëveprimit ligjor të AKA-së nuk janë të sakta, përfshirë,

por pa u kufizuar vetëm në, reklamimin e programeve të studimit pa akreditim nga KSHC, paraqitjen e specializimeve si programe në vete të studimit në kundërshtim me vendimin e akreditimit nga KSHC, paraqitjen e emërimit të institucionit në kundërshtim me vendimin e akreditimit nga KSHC-së, etj., AKA zyrtarisht i drejtohet institucionit përkatës me kërkesën për largimin e informatave të pasakta dhe përmirësimin e tyre në përputhje me vendimet e KSHC-së brenda 5 (pesë) ditëve të punës.

- 1.4.5. Në rast se institucioni dështon të bëjë zëvendësimin e informatave brenda periudhës kohore të caktuar AKA njofton KSHC-në.
- 1.4.6. Në qoftë se KSHC konsideron se arsyetimi i institucionit është i pabazuar dhe se institucioni me veprimet e tij ka cenuar rëndë kushtet e dhëna të akreditimit, KSHC vendosë që programi i studimi dhe/ose institucioni vendoset në proces të vlerësimit të jashtëm. Raporti i ekipit të vlerësuesve të jashtëm ndërkombëtarë, i dorëzohet KSHC-së dhe trajtohet në një tërësi nga mbledhjet e KSHC-së.
- 1.4.7. Pas marrjes së vendimit të KSHC-së, institucioni i arsimit të lartë mund të parashtojë ankesë sipas legjislacionit të AKA-së dhe ligjeve të përgjithshme në fuqi.
- 1.4.8. Vendimi i KSHC-së bëhet publik në ueb faqen e AKA-së.

## 1.5. MONITORIMIN SIPAS STANDARDEVE TË MANUALIT TË AKREDITIMIT

**Monitorimi sipas standardeve të Manualit të Akreditimit përfshin por nuk kufizohet vetëm në:**

### 1.6. Monitorimi i stafit akademik

- 1.6.1. Të paktën një herë brenda 6 (gjashtë) muajve, AKA bënë monitorimin e stafit akademik për çdo program të akredituar në Republikën e Kosovës.
- 1.6.2. Monitorimi i stafit akademik bëhet me qëllim për të siguruar se institucioni i arsimit të lartë është duke ofruar programin e studimit me stafin akademik ashtu siç është paraqitur në raportin e vetëvlerësimit.
- 1.6.3. Monitorimi i stafit akademik mund të bëhet në distancë, përmes verifikimit të orarit të ligjëratave i cili kërkohet të bëhet publik në uebfaqen e institucionit dhe/apo përmes vizitës fizike të AKA-së me apo pa paralajmërim në hapësirat e institucionit të arsimit të lartë.
- 1.6.4. Zyrtarët e AKA-së fillimisht bëjnë krahasimin në distancë të përputhshmërisë së të dhënave të paraqitura në RVV me orarin e publikuar të ushtrimeve dhe ligjëratave nga institucioni i arsimit të lartë. Sipas gjykimit të AKA-së, zyrtarët e AKA-së realizojnë një vizitë fizike në hapësirat e institucionit të arsimit të lartë për të vërtetuar mbajtjen e ligjëratave, ushtrimeve dhe praktikës së punës me stafin akademik të paraqitur në RVV.
- 1.6.5. Në rast të organizimit të vizitës së monitorimit pa paralajmërim, zyr-

tarët e AKA-së me rastin e arritjes në institucionin e arsimit të lartë i bëjnë të ditur përfaqësuesit të institucionit qëllimin e vizitës së monitorimit.

- 1.6.6. Me rastin e deklarimit të qëllimit të vizitës monitoruese, vizita kufizohet vetëm në marrjen e informacioneve dhe dëshmive që hyjnë në funksion të përmbushjes së qëllimit të vizitës.
- 1.6.7. Në rast se zyrtarët e AKA-së, qoftë përmes monitorimit në distancë, apo vizitës fizike në institucion, vërtetojnë përmes dëshmive të arsyeshme se një pjesë e stafit akademik, në bazë të së cilit programi i studimit është vlerësuar pozitivisht nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit, nuk janë prezent në institucionin e arsimit të lartë dhe të njëjtit nuk kanë më marrëdhënie kontraktuale me institucionin përkatës, AKA kërkon nga institucioni një arsyetim me shkrim për arsyet e largimit të stafit akademik.
- 1.6.8. Institucioni i arsimit të lartë obligohet brenda 3 ditëve të punës të dorëzoj në AKA arsyetimin sipas kërkesave të AKA-së.
- 1.6.9. Pas përfundimit të vizitës fizike të monitorimit dhe/apo pas pranimit të arsyetimit me shkrim të institucionit, zyrtarët e AKA-së hartojnë një raport me të gjeturat e procedurës së monitorimit. Ky raport reflekton vetëm gjendjen faktike të verifikuar nga zyrtarët e AKA-së dhe nuk përmban ndonjë rekomandim përfundimtar për KSHC-në.
- 1.6.10. KSHC në mbledhjen e ardhshme të rregullt, rishikon raportin e zyrtarëve të AKA-së së bashku me arsyetimin e pranuar nga institucioni i arsimit të lartë. Në qoftë se KSHC konsideron se arsyetimi i institucionit është i bazuar dhe se institucioni ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar zëvendësimin e stafit akademik me kualifikime të ngjashme sikurse stafi paraprak, KSHC mund të konfirmojë formalisht zëvendësimin e stafit akademik të institucionit të arsimit të lartë.
- 1.6.11. Në qoftë se KSHC konsideron se arsyetimi i institucionit është i pabazuar dhe se institucioni me veprimet e tij ka cenuar rëndë kushtet e dhëna të akreditimit, KSHC vendosë që programi i studimi dhe/ose institucioni vendoset në proces të vlerësimit të jashtëm. Raporti i ekipit të vlerësuesve të jashtëm ndërkombëtarë, i dorëzohet KSHC-së dhe trajtohet në njërin nga mbledhjet e KSHC-së.

- 1.6.12. Pas marrjes së vendimit të KSHC-së, institucioni i arsimit të lartë mund të parashtrojë ankesë sipas legjislacionit të AKA-së dhe ligjeve të përgjithshme në fuqi.
- 1.6.13. Vendimi i KSHC-së bëhet publik në ueb faqen e AKA-së.

## **1.7. Monitorimi i orareve të ligjëratave dhe ushtrimeve**

- 1.7.1. Të paktën një herë brenda 6 (gjashtë) muajve, AKA bënë monitorimin e orareve të ligjëratave dhe ushtrimeve për çdo program të studimit të akredituar në Republikën e Kosovës.
- 1.7.2. Monitorimi i orareve të ligjëratave bëhet me qëllim për të siguruar përputhshmërinë e planprogramit të akredituar sipas Raportit të vetëvlerësimit, sipas Manualit të Akreditimit (lëndët obligative dhe zgjedhore, fondi i orëve të ligjëratave dhe ushtrimeve, puna praktike si dhe bartësin e lëndës përkatëse) me orarin e ligjëratave dhe ushtrimeve të publikuar nga institucioni i arsimit të lartë.
- 1.7.3. Monitorimi i orareve të ligjëratave dhe ushtrimeve mund të bëhet në distancë, përmes verifikimit të orarit, i cili kërkohet të bëhet publik në ueb faqen e institucionit dhe/apo përmes vizitës fizike të AKA-së me apo pa paralajmërim në hapësirat e institucionit të arsimit të lartë.
- 1.7.4. Zyrtarët e AKA-së fillimisht bëjnë krahasimin në distancë të përputhshmërisë së të dhënave të paraqitura në RVV me orarin e publikuar të ushtrimeve dhe ligjëratave nga institucioni i arsimit të lartë. Zyrtarët e AKA-së realizojnë një vizitë fizike në hapësirat e institucionit të arsimit të lartë për të vërtetuar mbajtjen e ligjëratave, praktikës dhe ushtrimeve sipas të dhënave të paraqitura në RVV dhe orarit të publikuar.
- 1.7.5. Në rast të organizimit të vizitës së monitorimit pa paralajmërim, zyrtarët e AKA-së me rastin e arritjes në institucionin e arsimit të lartë, do t'i bëjnë të ditur përfaqësuesit të institucionit që ka filluar procedura e monitorimit dhe për qëllimin e vizitës së monitorimit. Me rastin e deklarimit të qëllimit të vizitës monitoruese, vizita kufizohet



vetëm në marrjen e informacioneve dhe dëshmime që hyjnë në funksion të përmbushjes së qëllimit të vizitës.

- 1.7.6. Në rast se zyrtarët e AKA-së, qoftë përmes monitorimit në distancë apo vizitës fizike në institucion, vërtetojnë përmes dëshmime të arsyeshme se një pjesë e stafit akademik nuk janë prezentë në ligjërata dhe/apo ushtrime dhe/apo punë praktike, dhe se procesi mësimor nuk është duke u mbajtur në përputhje me fondin e orëve të paraqitur në RVV, AKA kërkon nga institucioni një arsyetim me shkrim për arsyet e mungesës së stafit në mësim apo ndryshimit të procesit mësimor.
- 1.7.7. Institucioni i arsimit të lartë obligohet brenda 3 ditëve të punës të dorëzoj në AKA arsyetimin sipas kërkesave të AKA-së.
- 1.7.8. Pas përfundimit të vizitës fizike të monitorimit dhe/apo pas pranimit të arsyetimit me shkrim të institucionit, zyrtarët e AKA-së hartojnë një raport me të gjeturat e procedurës së monitorimit. Ky raport reflekton vetëm gjendjen faktike të verifikuar nga zyrtarët e AKA-së dhe nuk përmban ndonjë rekomandim përfundimtarë për KSHC-në.
- 1.7.9. KSHC-në në mbledhjen e ardhshme të rregullt, rishikon raportin e zyrtarëve të AKA-së së bashku me arsyetimin e pranuar nga institucioni i arsimit të lartë. Në qoftë se KSHC konsideron se arsyetimi i institucionit është i bazuar dhe se institucioni ka ndërmarrë gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar zëvendësimin e orëve të humbura mësimore dhe/ apo përshtatjen e plan programit, KSHC mund të konfirmojë formalisht arsyetimin e institucionit të arsimit të lartë.
- 1.7.10. Në qoftë se KSHC konsideron se arsyetimi i institucionit është i pabazuar dhe se institucioni me veprimet e tij ka cenuar rëndë kushtet e dhëna të akreditimit, KSHC formalisht kërkon nga institucioni përmirësimin e gjendjes brenda një afati kohor i cili përcaktohet nga KSHC.
- 1.7.11. Institucioni i arsimit të lartë brenda periudhës kohore të përcaktuar nga KSHC ofron dëshmi të bazuara tek AKA për përmirësimin e gjendjes si dhe mund të kërkojë takim formal konsultativ me Drejtorin e AKA-së dhe/apo anëtarët e KSHC-së.
- 1.7.12. Nëse edhe pas dhënies së afatit shtesë kohor, institucioni dështon të dorëzoj dëshmi relevante për përmirësimin e gjendjes, KSHC e vendosë programin e studimit dhe/ose institucionin në proces të vlerësimit të jashtëm. Raporti i ekipit të vlerësuesve të jashtëm ndërkombëtarë, i

- dorëzohet KSHC-së dhe trajtohet në njërin nga mbledhjet e KSHC-së..
- 1.7.13. Pas marrjes së vendimit të KSHC-së, institucioni i arsimit të lartë mund të parashtrojë ankesë sipas legjislacionit të AKA-së dhe ligjeve të përgjithshme në fuqi.
- 1.7.14. Vendimi i KSHC-së bëhet publik në ueb faqen e AKA-së.

## **1.8. Monitorimi i infrastrukturës dhe resurseve**

- 1.8.1. Të paktën një herë brenda 6 (gjashtë) muajve, AKA bënë monitorimin e infrastrukturës dhe resurseve të çdo institucioni të akredituar të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.
- 1.8.2. Monitorimi i infrastrukturës dhe resurseve bëhet me qëllim për të siguruar se institucionet e arsimit të lartë mirëmbajnë standardet e Manualit të Akreditimit të paraqitura në Raportin e Vet Vlerësimit, Infrastruktura dhe resurseve, sidomos në programet e studimit të cilat pjesë përbërëse të tyre përfshijnë punën praktike dhe laboratorike.
- 1.8.3. Monitorimi i infrastrukturës dhe resurseve bëhet vetëm përmes vizitës fizike të AKA-së me apo pa paralajmërim në hapësirat e institucionit të arsimit të lartë.
- 1.8.4. Në rast të organizimit të vizitës së monitorimit pa paralajmërim, zyrtarët e AKA-së me rastin e arritjes në institucionin e arsimit të lartë i bëjnë të ditur përfaqësuesit të institucionit qëllimin e vizitës së monitorimit.
- 1.8.5. Me rastin e deklaramentit të qëllimit të vizitës monitoruese, vizita kufizohet vetëm në marrjen e informacioneve dhe dëshmive që hyjnë në funksion të përmbushjes së qëllimit të vizitës..
- 1.8.6. Në rast se zyrtarët e AKA-së vërtetojnë përmes dëshmive të arsyeshme se një pjesë e laboratorëve, hapësirave të punës praktike dhe/apo pajisjet laboratorike nuk janë funksionale dhe/apo nuk shfrytëzohen si pjesë përbërëse e procesit mësimor, AKA do të kërkojë nga institucioni një arsyetim me shkrim për arsyet e mungesës së funksionalizimit të infrastrukturës fizike.
- 1.8.7. Institucioni i arsimit të lartë obligohet brenda 3 ditëve të punës të dorëzojë në AKA arsyetimin sipas kërkesave të AKA-së.

- 1.8.8. AKA mund të kërkojë ndihmë nga ndonjë palë e tretë, sikurse ndonjë ekspert dhe/ose ekip të ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, për verifikimin e pajisjeve laboratorike të cilat mund të jenë të panjohura për zyrtarët e AKA-së.
- 1.8.9. Pas përfundimit të vizitës fizike të monitorimit dhe/apo pas pranimit të arsyetimit me shkrim të institucionit, zyrtarët e AKA-së hartojnë një raport me të gjeturat e procedurës së monitorimit. Ky raport reflekton vetëm gjendjen faktike të verifikuar nga zyrtarët e AKA-së dhe nuk përmban ndonjë rekomandim përfundimtarë për KSHC-në.
- 1.8.10. KSHC-në në mbledhjen e ardhshme të rregullt, rishikon raportin e zyrtarëve të AKA-së së bashku me arsyetimin e pranuar nga institucioni i arsimit të lartë. Në qoftë se KSHC konsideron se arsyetimi i institucionit është i bazuar dhe se institucioni ka ndërmarrë gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar funksionalizimin e infrastrukturës fizike, KSHC mund të konfirmojë formalisht arsyetimin e institucionit të arsimit të lartë.
- 1.8.11. Në qoftë se KSHC konsideron se arsyetimi i institucionit është i pabazuar dhe se institucioni me veprimet e tij ka cenuar rëndë kushtet e dhëna të akreditimit, KSHC vendosë së programi i studimit dhe/ose institucioni të vendoset në proces të vlerësimit të jashtëm. Raporti i ekipit të vlerësuesve të jashtëm ndërkombëtarë, i dorëzohet KSHC-së dhe trajtohet në njërën nga mbledhjet e KSHC-së. Pas marrjes së vendimit të KSHC-së, institucioni i arsimit të lartë mund të parashtrojë ankesë sipas legjislacionit të AKA-së dhe ligjeve të përgjithshme në fuqi.
- 1.8.12. Vendimi i KSHC-së bëhet publik në ueb faqen e AKA-së.

## 1.9. MONITORIM I JASHTËZAKONSHËM

**Monitorimi i jashtëzakonshëm përfshin por nuk kufizohet vetëm në:**

### **Monitorimi i iniciuar pas pranimit të ankesave nga palët e jashtme**

- 1.9.1. AKA mund të pranojë në çdo kohë ankesa të dorëzuara nga individë apo organizata të cilët vejnë në pah rënie të cilësisë së institucioneve të arsimit të lartë dhe/apo programeve të tyre të studimit.
- 1.9.2. Ankesat e dorëzuara në AKA do të konsiderohen anonime dhe identiteti i personave të cilët dorëzojnë ankesën nuk shpaloset.
- 1.9.3. Ankesat duhet të kufizohen vetëm në shqetësimet e palëve në lidhje me përmbushjen e standardeve të Manualit të Akreditimit nga institucioni i arsimit të lartë dhe jo në arsye tjera jashtë fushëveprimit ligjor të AKA-së.
- 1.9.4. Ankesat e dorëzuara në AKA duhet të jenë përmbajtjesore, të bazuara në dëshmi dhe të besueshme në mënyrë që AKA të procedojë atë në njërin nga mbledhjet e radhët së KSHC-së.
- 1.9.5. Në rast se KSHC konsideron se ankesa e dorëzuar në AKA është e bazuar, atëherë KSHC kërkon nga institucioni përkatës që brenda një periudhe kohore të caktuar të dorëzojë një raport i cili paraqet qëndrimin e tij karshi ankesës së dorëzuar.
- 1.9.6. KSHC-në në mbledhjen e ardhshme të rregullt, rishikon raportin e institucionit. Në qoftë se KSHC konsideron se arsyetimi i institucionit është i bazuar dhe se institucioni nuk ka pësuar rënie të cilësisë, KSHC nuk inicion procedurë karshi institucionit.
- 1.9.7. Në qoftë se KSHC konsideron se arsyetimi i institucionit është i pabazuar, KSHC formalisht kërkon nga institucioni përmirësimin e

gjendjes brenda një afati kohor i cili përcaktohet nga KSHC dhe/apo organizimin e një vizite të monitorimit nga zyrtarët e AKA-së.

- 1.9.8. Institucioni i arsimit të lartë brenda periudhës kohore të përcaktuar nga KSHC i siguron dëshmitë qoftë duke i dërguar në formë elektronike në AKA apo duke i prezantuar ato gjatë vizitës së monitorimit nga zyrtarët e AKA-së.
- 1.9.9. Nëse edhe pas dhënies së afatit shtesë kohor, institucioni dështon të dorëzoj dëshmi relevante për përmirësimin e gjendjes, KSHC procedon me iniciimin e vizitës së parakohshme të akreditimit në nivel institucional dhe/apo në nivel të programit të studimit. Raporti i ekipit të vlerësuesve të jashtëm ndërkombëtarë, i dorëzohet KSHC-së dhe trajtohet në njërën nga mbledhjet e KSHC-së.
- 1.9.10. Pas marrjes së vendimit të KSHC-së, institucioni i arsimit të lartë mund të parashtrojë ankesë sipas legjislacionit të AKA-së dhe ligjeve të përgjithshme në fuqi.

## 1.10. Dorëzimi i dëshmive të rrejshme në AKA

- 1.10.1. Në rast se AKA vihet në dijeni se, me qëllim të marrjes së vendimit për akreditim, riakreditim ose validim, institucioni i arsimit të lartë ka dorëzuar informacione të rrejshme në cilindo fazë të procesit të vlerësimit dhe akreditimit, AKA njofton zyrtarisht KSHC-në në mbledhjen e radhës.
- 1.10.2. Në rast se KSHC konsideron se njoftimi i AKA-së është i bazuar, atëherë KSHC kërkon nga institucioni përkatës që brenda një periudhe kohore të caktuar të dorëzojë një raport i cili paraqet qëndrimin e tij karshi njoftimit të AKA-së.
- 1.10.3. KSHC-në në mbledhjen e ardhshme të rregullt, rishikon raportin e institucionit. Në qoftë se KSHC konsideron se arsyetimi i institucionit është i bazuar dhe se institucioni nuk ka dorëzuar dëshmi të rrejshme për qëllim të marrjes së akreditimit, KSHC nuk iniciacion procedurë karshi institucionit.
- 1.10.4. Në qoftë se KSHC konsideron se arsyetimi i institucionit është i

pabazuar, KSHC vendosë që programi i studimit dhe/ose institucioni të vendoset në proces të vlerësimit të jashtëm. Raporti i ekipit të vlerësuesve të jashtëm ndërkombëtarë, i dorëzohet KSHC-së dhe trajtohet në një rën nga mbledhjet e KSHC-së.

- 1.10.5. Pas marrjes së vendimit të KSHC-së, institucioni i arsimit të lartë mund të parashtrojë ankesë sipas legjislacionit të AKA-së dhe ligjeve të përgjithshme në fuqi.

## **1.11. Monitorimi në bashkëpunim me Inspektoratin e Arsimit**

- 1.11.1. AKA mund të ketë kërkesë nga Inspektorati i Arsimit për të kryer një vizitë fizike të monitorimit në institucionet e akredituara të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.
- 1.11.2. Vizitat e tilla të monitorimit, në të cilat zyrtarët e AKA-së marrin pjesë, kufizohen vetëm në verifikimin e kushteve teknike të dhëna të akreditimit.
- 1.11.3. Koha dhe agjenda e vizitës fizike të monitorimit në institucionin e arsimit të lartë përcaktohet në bashkëpunim me zyrtarët e Inspektoratit i Arsimit.
- 1.11.4. Zyrtarë e AKA-së pjesëmarrës në vizitën e tillë të monitorimit, mbajnë shënime dhe hartojnë një procesverbal apo kontribuojnë në hartimin e procesverbalit të përbashkët me zyrtarët e Inspektoratit të Arsimit.
- 1.11.5. Në rast se procesverbali i vizitës së monitorimit, vë në pah shkelje të kushteve të dhëna të akreditimit sipas vendimit të KSHC-së, AKA dërgon procesverbalin e tillë në KSHC për shqyrtim.
- 1.11.6. KSHC pas rishikimit të procesverbalit kërkon nga institucioni përkatës që brenda një periudhe kohore të caktuar të dorëzojë një raport i cili paraqet qëndrimin e tij.

- 1.11.7. Në qoftë se KSHC konsideron se arsyetimi i institucionit është i bazuar, KSHC nuk inicion asnjë procedurë karshi institucionit.
- 1.11.8. Në qoftë se KSHC konsideron se arsyetimi i institucionit është i pabazuar, KSHC vendosë që programi i studimit dhe/ose institucioni të vendoset në proces të vlerësimit të jashtëm. Pas marrjes së raportit nga ekipi i vlerësuesve të jashtëm ndërkombëtarë, raporti i dorëzohet KSHC-së dhe trajtohet në njërën nga mbledhjet e KSHC-së.
- 1.11.9. KShC vendosë si të procedohet tutje.
- 1.11.10. Pas marrjes së vendimit të KSHC-së, institucioni i arsimit të lartë mund të parashtrojë ankesë sipas legjislacionit të AKA-së dhe ligjeve të përgjithshme në fuqi.





# 2 PROCEDURAT PAS AKREDITUESE

Procedurat pas akredituese janë pjesë përbërëse e procesit të vlerësimit të jashtëm të cilësisë së IAL-ve dhe mbyllin ciklin e akreditimit.

Procedurat pas akredituese kufizohen në verifikimin e kushteve të akreditimit dhe konfirmimin e shkallës së përmbushjes së rekomandimeve nga AKA dhe zotimeve nga IAL dhe jo në rivlerësimin e standardeve të Manualit të Akreditimit.



Procedurat pas akredituese janë si në vijim:

## **2.1. Organizimi i procedurës pas akredituese nga AKA**

- 2.1.1. AKA organizon procedurën pas akredituese të paktën njëherë brenda kohëzgjatjes së akreditimit të nivelit institucional dhe/apo të programit të studimit për çdo institucion të akredituar të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.
- 2.1.2. Për të siguruar koherencë të veprimeve, AKA siguron t'i fillojë procedurat pas akredituese për programet e studimit të cilat i janë nënshtruar procesit të akreditimit, sipas afateve kohore të rekomandimeve të AKA-së dhe zotimeve nga IAL.
- 2.1.3. AKA angazhon nga një ekspert ndërkombëtar të akreditimit për procedurat pas akredituese për secilin program të studimit apo për nivelin institucional për çdo institucion të akredituar të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës.
- 2.1.4. Institucioni i arsimit të lartë njoftohet zyrtarisht nga AKA për fillimin e procedurës pas akredituese për nivelin e akreditimit institucional dhe/apo në nivelin e programeve të studimit.
- 2.1.5. Procedurat pas akredituese mund të zhvillohen me vizita fizike apo në distancë.
- 2.1.6. Raporti i hartuar nga eksperti ndërkombëtar për shkallën e përmbushjes së rekomandimeve nga institucioni i arsimit të lartë shqyrtohet dhe aprovohet në mbledhjet e KSHC-së.
- 2.1.7. Raporti i procedurës pas akredituese së bashku me vendimin e KSHC-së për institucionin përkatës të arsimit të lartë publikohet në ueb faqen zyrtare të AKA-së.
- 2.1.8. Raporti i procedurës pas akredituese është pjesë përbërëse e dokumentacionit për procedurën e ardhshme të ri/akreditimit të institucionit të arsimit të lartë.

## 2.2. Dorëzimi i raportit fillestar të përmirësimit

- 2.2.1. Çdo IAL, jo më larg se 90 ditë kalendarike pas marrjes së vendimit për akreditim dhe/apo riakreditim në nivel institucional dhe/apo në nivel të programit të studimit, dorëzon në AKA një raport fillestar të përmirësimit.
- 2.2.2. Raporti i përmirësimit dorëzohet në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze, në formë elektronike ashtu siç përcaktohet nga AKA.
- 2.2.3. Raporti i përmirësimit është dokument zyrtar në të cilin institucioni i arsimit të lartë adreson individualisht rekomandimet e dhëna nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit në raportin e vlerësimit të jashtëm për çdo standard të fushës së përgjithshme të Manualit të Akreditimit.
- 2.2.4. Raporti i përmirësimit përbëhet nga një elaborim përmbajtjesor, i bazuar në dëshmi dhe në planifikim real se cilat veprime i ndërmerr institucioni i arsimit të lartë për të adresuar individualisht rekomandimet e ekspertëve.
- 2.2.5. Raporti i përmirësimit përfshinë gjithashtu kohën e planifikuar të përmbushjes së rekomandimeve e cila vendoset nga vet IAL apo ashtu siç është sugjeruar tekstualisht nga ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit në raportin e vlerësimit.

## 2.3. Dorëzimi i raportit përfundimtar të përmirësimit

- 2.3.1. IAL dorëzon në AKA raportin e plotë të përmirësimit në të cilin paraqet progresin e arritur dhe aktivitetet e mbetura të nevojshme për përmbushjen e plotë të rekomandimeve të ekspertëve, sipas afateve të rekomandimeve të AKA dhe zotimeve nga IAL.
- 2.3.2. Krahas raportit të përmirësimit, institucioni mund të dorëzojë edhe dëshmi të tjera relevante të cilat dëshmojnë për përmbushjen e rekomandimeve përkatëse.
- 2.3.3. AKA mund të kërkojë nga institucioni plotësime të nevojshme të do-

kumentit nëse konsiderohet se raporti nuk përmbush nevojat e procedurave pas akredituese. Pas dorëzimit të versionit të përmirësuar, dokumenti konsiderohet përfundimtar.

## **2.4. Angazhimi i ekspertit ndërkombëtar të akreditimit**

- 2.4.1. AKA i dërgon ekspertit ndërkombëtar të akreditimit planin e përmirësimit të institucionit, dëshmitë tjera relevante, nëse ka, raportin e vlerësimit të jashtëm si dhe çdo dokument tjetër i cili është i nevojshëm për të përmbushur nevojat e procedurës pas akredituese..
- 2.4.2. Në rastin e angazhimit të një eksperti tjetër ndërkombëtar të akreditimit, AKA siguron të gjitha informatat kontekstuale për institucionin dhe/apo programin e studimit..
- 2.4.3. Eksperti ndërkombëtar rishikon dokumentacionin e plotësuar vetëm për qëllim të verifikimit dhe konfirmimit të përmbushjes së kushteve të akreditimit dhe rekomandimeve nga ana e institucionit të arsimit të lartë.
- 2.4.4. Në rast se eksperti ndërkombëtar konsideron se raporti i përmirësimit ka informacione të mangëta të cilat nuk mundësojnë verifikimin e përmbushjes së rekomandimeve, AKA mund të kërkojë informata shtesë nga institucioni i arsimit të lartë.
- 2.4.5. Institucioni i arsimit të lartë do të dërgojë informatat shtesë brenda 7 ditëve pune prej datës së pranimit të kërkesës nga AKA. Informatat shtesë kufizohen vetëm në dëshmitë të cilat janë relevante për verifikimin e përmbushjes së rekomandimeve të dhëna në raportin e vlerësimit.
- 2.4.6. Brenda 14 ditëve kalendarike pas pranimit të dokumentacionit shtesë nga AKA, eksperti ndërkombëtar i akreditimit harton një raport me shkrim sipas shabllonit të aplikuar nga AKA në të cilin do të konfirmojë shkallën e përmbushjes së rekomandimeve nga institucioni përkatës.
- 2.4.7. Raporti i ekspertit ndërkombëtar i dërgohet institucionit përkatës

për të komentuar gjendjen faktike të verifikuar sipas ekspertit.

- 2.4.8. Institucionit i mundësohet dërgimi i komenteve për raportin e procedurës pas akredituese brenda 7 ditëve kalendarike nga data e pranimi të raportit nga AKA.
- 2.4.9. Pas pranimi të komenteve nga Institucioni, AKA i dërgon komentet me shkrim ekspertit ndërkombëtar për finalizimin e raportit të procedurës pas akredituese.
- 2.4.10. Eksperti ndërkombëtar, 7 ditë kalendarike pas marrjes së komenteve nga institucioni, finalizon raportin e procedurës akredituese.
- 2.4.11. Raporti final i procedurës pas akredituese i hartuar nga eksperti ndërkombëtar, i dorëzohet anëtarëve të KSHC-së dhe trajtohet në një rën nga mbledhjet e KSHC-së.

## **2.5. Organizimi i vizitës fizike pas akredituese në institucionin e arsimit të lartë**

- 2.5.1. Në rast se AKA apo eksperti ndërkombëtar i akreditimit konsideron se verifikimi i përmbushjes së rekomandimeve nuk mund të bëhet në distancë, atëherë mund të procedohet me organizimin e një vizite fizike apo online të procedurës pas akredituese.
- 2.5.2. Vizita fizike apo online e procedurës pas akredituese organizohet në përputhje me parimet e Manualit të Akreditimit të cilat vlejné për vizitën e akreditimit.
- 2.5.3. Eksperti ndërkombëtar i akreditimit, në konsultim me AKA, vendos për kohëzgjatjen e vizitës së procedurës pas akredituese si dhe agjendën e takimeve..
- 2.5.4. AKA këshillon institucionin e arsimit të lartë për kohën e organizimit të vizitës pas akredituese si dhe për agjendën e vizitës.
- 2.5.5. Agjenda e vizitës pas akredituese kufizohet vetëm në pjesëmarrësit të cilët janë të nevojshëm për të përmbushur kërkesat e vizitës së procedurës pas akredituese.
- 2.5.6. Vizita e procedurës pas akredituese kufizohet vetëm në verifikimin dhe konfirmimin e shkallës së përmbushjes së rekomandimeve nga

institucioni i arsimit të lartë dhe jo në ri vlerësimin e standardeve të Manualit të Akreditimit.

- 2.5.7. Pas vizitës së procedurës akredituese, eksperti mund të kërkojë dëshmitë shtesë të cilat i janë prezantuar ekspertit gjatë vizitës pas akredituese dhe të cilat nuk kanë qenë pjesë e raportit të përmirësimit të dërguar fillimisht nga institucioni i arsimit të lartë.
- 2.5.8. Institucioni i arsimit të lartë do të ketë 2 ditë kalendarike kohë për dorëzimin e dëshmimeve shtesë në AKA. Dëshmitë e tilla kufizohen vetëm në dokumentacionin të cilin eksperti e ka konsideruar si relevant për të verifikuar përmbushjen e rekomandimeve nga ana e institucionit.
- 2.5.9. Brenda 14 ditëve kalendarike pas pranimit të dëshmimeve shtesë nga AKA, eksperti ndërkombëtar harton një raport sipas shabllonit të aplikuar nga AKA në të cilin konfirmon shkallën e përmbushjes së rekomandimeve nga institucioni përkatës.
- 2.5.10. Raporti i hartuar nga eksperti ndërkombëtar i dërgohet institucionit përkatës për të komentuar gjendjen faktike të verifikuar sipas ekspertit.
- 2.5.11. Institucionit i mundësohet dërgimi i komenteve për raportin e procedurës pas akredituese brenda 7 ditëve kalendarike nga data e pranimit të raportit nga AKA.
- 2.5.12. Pas pranimit të komenteve nga Institucioni, AKA i dërgon komentet ekspertit ndërkombëtar për finalizimin e raportit të procedurës pas akredituese.
- 2.5.13. Eksperti ndërkombëtar, të paktën 7 ditë kalendarike pas marrjes së komenteve nga institucioni, finalizon raportin e procedurës akredituese.

## 2.6. Konfirmimi i raportit të procedurës pas akredituese nga KSHC

- 2.6.1. Raporti final i procedurës pas akredituese i hartuar nga eksperti ndërkombëtar i akreditimit për institucionin përkatës të arsimit të lartë, i dorëzohet anëtarëve të KSHC-së për shqyrtim.
- 2.6.2. KSHC shqyrton gjetjet e raportit të procedurës pas akredituese përmes një konstatimi, i cili nëse është pozitiv shkruhet në proces-verbal.
- 2.6.3. Në rast se raporti i procedurës pas akredituese, konfirmon se institucioni i arsimit të lartë nuk ka plotësuar rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit sipas kohës së rekomanduar në raportin e jashtëm, KSHC mund të kërkojë iniciimin e procedurës së parakohshme të akreditimit në përputhje me Ligjin për AKA-në, aktet nënligjore dhe Manualin për Akreditim.
- 2.6.4. Në rast se KSHC konstaton se AKA ka bërë shkelje gjatë administrimit të procedurës pas akredituese, KShC vendosë ta kthej rastin në rishqyrtim..
- 2.6.5. Institucioni i arsimit të lartë njoftohet zyrtarisht nga AKA për përmbylljen e procedurës pas akredituese e cila është aplikuar në nivelin institucional dhe/apo në nivelin e programit të studimit.
- 2.6.6. Institucioni i arsimit të lartë ka të drejtë të paraqes ankesë ndaj vendimit të KSHC në përputhje me bazën ligjore të AKA-së si dhe ligjet e përgjithshme në fuqi.

